



Shoqëria "PRIMA sh.p.k"
Rruga Konferenca e Pezës, Tiranë

RAPORTI TEKNIK

"Prodhim, paketim i makaronave"


Baza ligjore:

VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtojca II "Projektet qe i nenshtrohen procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis", Pika 7. Industria ushqimore. b) Prodhimi, perpunimi dhe paketimi dhe i produkteve shtazore dhe bimore

Hartoi raportin

Vita BESHIRI


Prima
Rr. Konferenca e Pezës
Tiranë
K32419001R

a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar

Shoqëria "Prima" sh.p.k. kërkon të zhvillojë aktivitetin "Prodhim, paketim i makaronave" me vendodhje Nj.A. Nr. 6, Rruga "3 Dëshmoret", Tirane.

Ne baze të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440", datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtojca II "Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis", Pika 7. Industria ushqimore. b) Prodhimi, përpunimi dhe paketimi dhe i produkteve shtazore dhe bimore.

Shoqëria "PRIMA" shpk ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj prodhimin dhe konfeksionimin e makaronave të shkurtra, të gjata dhe nidi me të cilat mbulon 50-60% të nevojave për tregun vendas.

Te dhenat e shoqërisë:

Personi Juridik: "Prima" sh.p.k.

NIPT-i: K32419001R

Adresa e selisë: Nj. A. nr.6, Rr. "Konferenca e Pezës", ZK 8240, nr. pasurie 2/137 dhe 2/138, ne ambjentet

e fabrikes se shoqërisë "Bloja"sh.a.

Administratori: Agron Haxhiymeri

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit

ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGER, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë

Veprimtaria zhvillohet në objektin dhe truallin e marrë me qera të ndodhur në rrugë n "3 Dëshmorët", ku shoqëria "Bloja" sh.a. i jep ambjente me qera shoqërisë "Prima" sh.p.k. nepermjet kontrates se qerese datë 10.04.2018, Nr.2481 Rep. 883 Kol (bashkangjitur kontrata ku jepen specifikime per cdo siperfaqe)

Te dhena mbi truallin:

- 1. Siperfaqja e dhene me qera ku zhvillohet aktiviteti: 4 512 m²**
- 2. Zona Kadastrale: 8240**
- 3. Nr.Pas 2/137 dhe 2/138**


Koordinatat dhe planvendosja e objektit ne studim

Pika	1	2	3	4	5
X	4398572.23	4398611.44	4398769.33	4398750.66	4398683.86
Y	4577264.99	4577313.27	4577162.74	4577146.71	4577182.21



c) informacionin për gendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Objekti ndodhet ne nje zone mjaft te zhvilluar te kryeqytetit. Ajo njihet ndryshe si Unaza e Re. Nodhet ne Nj.A. Nr. 6. Eshte nje njesi e cila se fundmi eshte e populluar me banore te ardhur kryesisht nga jugu I Shqiperise me nje popullsi prej afro 46 000 banore.



Sic edhe shihet nga pamjet satelitore, objekti ndodhet buze unazes se re. Zona eshte edhe e banuar, por ka edhe shume ambjente tregtare, sherbimi argetimi etj.

Ndodhet buze rruges dhe shume prane zonave te banuara. Objekti i fabrikes “Bloja”, ne ambjentet e se ciles operon “Prima” sh.p.k. eshte ekzistues qysh ne vitet '90, ku toka ishte ende e pa zaptuar nga levizja e lire e popullsisë. Pra duhet theksuar se objektet e tjera perreth, infrastruktura etj, u zhvilluan pas viteve 2000, si pasoje e siper marrjes se lire, e cila u shoqerua me nje fluks te madh ndertimesh pa leje.

Zona ka qene informale deri ne vitin 2006, kur edhe filloi procesi I legalizimit nepermjet ALUIZNI-it.

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit



d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

Shoqëria "PRIMA" shpk ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj prodhimin dhe konfeksionimin e makaronave të shkurtëra dhe të gjata dhe nidi me të cilat mbulon 50-60% të nevojave për tregun vendas.

Prodohen 3 tipe makaronash me një kapaciteti prodhues 250 ton makarona të gjata dhe 250 ton të shkurtra, pra ne total **kapaciteti I linjes shkon 500 ton.**

1.Makarona të gjata, spageti_3 lloje, spageti 8, spageti 10, fettucine 12, bukatini 6

2.Makarona të shkurtra_pennoni rigati 29, fusili 40, cornetti rigati 48, cornet lisci 49, lumachine 52, chifferi rigati 53, abissini 54, conchiglie 59, anellini 62, pignolina 71, stelline 74, fillini 79.

3.Nidi

Lëndët e para mielli SEMOLA nga gruri i fortë Durum (i cilësisë së lartë që merret nga shoqëria prodhimit të miellit "BLOJA" sh.p.k.

Lëndë ndihmëse: ujë , energji elektrike.

Teknologjia e përdorur është teknologji bashkohore e automatizuar, tërësisht e kompjuterizuar nga kompania italiane"PAVAN" spa. Proceset kryesore për prodhimin e të dy llojeve të makaronave janë :

- Përzierja e lëndëve të para (semola ujë etj)
- Presimi
- Kalibrimi dhe dhënia e formës
- Tharja
- Ftohja
- Paketimi

Përzierja e lëndëve të para (semola ujë etj) në nkupton përzierjen e semolas me ujin (dhe element të tjerë nëse kërkohet) për të formuar një brumë të shkrifët (përzierje jo homogjene).

Presimi_ brumit i ushtrohet një forcë (presohet) në forma të ndryshme (inserte) nën presion shumë të lartë për të përfutur një gamë të madhe të formave të makaronave (tipe të ndryshme).Dhoma e shtrydhjes është projektuar për transmetim të nxehtësisë dhe flocave të fërkimit që krijohen gjatë procesit të shtrydhjes. Për të evituar fenomenin e

ngjitjes ndërmjet makaronave, produkti i posashtrydhur i nënshtrohet një rryme ajri të menjëhershëm para prodhimit në procesin e tharjes.

Kalibrimi dhe dhënia e formës (ose inserti) përbën komponentin bazë të presës dhe dinamika e procesit të makaronave. Brumi i formuar në vaskën përzierse lëvis nëpërmjet vidës së komprimimit në drejtim të kokës së presës (testates) dhe presohet në trafile ose më saktë në c`do insert. Inserti është kompozuar për të mbajtur këtë forcë dhe lëvizja e brumit nëpërmjet tij krijon formën e tipit të makaronave. Forma dhe tipi i insertit përcakton formën finale të makaronave. Brumi i presuar në insert jep dhe bazën e strukturës së makaronave, në formë tubi, spirale apo me vrimë. Pas insertit (trafiles) qëndron thika e cila pret brumin për formën përfundimtare.

Inserti është elementi më i rëndësishëm i prodhimit të makaronave. Prej tij (sipas formës së c`do formati) fillon termodinamika e tharjes. Pra inserti krijon masën e produktit që do të kalojë në procesin e tharjes.

Tharja & Ftohja. Tharja është pjesë kritike e procesit të prodhimit të makaronave nga e cila varet cilësia e tyre. Lagështia, lëvizja e ajrit dhe temperatura janë të kontrolluara me kujes gjatë kalimit të makaronave në zona të ndryshme të tharjes. Temperaturat e larta moderne të tharjes përmirsojnë ngjyrën dhe cilësinë e zierjes. Në fazën finale të tharjes dhoma e ftohjes rikthen makaronat në kushte atmosferike normale. Në përgjithësi produkti final "makarona" thahet në një lagështi relative 12.5%. Koha totale e tharjes zgjat 8 orë. Gjatë procesit të tharjes produkti final pëson një humbje prej 21.5% të masës së lagët (semola+ujë) si pasojë e avullimit.

Paketimi është procesi përfundimtar. Cdo parti furnizimi me film paketimi dhe karton shoqërohet me certifikatë cilësie pasi paketimi është elementi bazë i ruajtjes së cilësisë së produktit që ambalazhohet i destinuar për ruajtje. Tek makaronat elementet që përdoren për paketim janë filmi i politilenit dhe kutitë e kartonit. Paketimi duhet të sigurojë mbrojtjen e produktit nga zhvillimet mikrobike dhe ruajtjen e lagështirës në kufijt e sigurisë 12.5%. Cilësia e filmit të qeses dhe kartonit janë elementët kryesorë për një paketim të sigurt. Qesja (filmi) duhet të jetë antimikrobike dhe nuk duhet të përmbajë oksigjen.



dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

***Furnizimi me energji elektrike dhe telefoni.**

Furnizimi me energji elektrike është parashikuar të bëhet nga rrjeti lokal i tensionit të mesëm 6-10kV të OSHEE-së. Në rastin konkret do të bëhet linja elektrike e tensionit të mesëm 6-10kv dhe kabina e trasformatorit 30KVA, konform kërkesave dhe kushteve teknike të përcaktuara nga OSHEE.

Furnizimi i emergjencës

Për të garantuar furnizim të vazhdueshëm për ambientet e stacionit, pajisjeve dhe aparaturave është parashikuar një impaint baterish, i cili është projektuar që të plotësojë të gjitha kërkesat e shfrytëzimit të pajisjeve të telekominikacionit në stacion. Montimi i tyre do të bëhet në përputhje me rregullat e shfrytëzimit teknik të prodhuesit dhe sipas rregullores së shfrytëzimit të pajisjeve dhe impianteve elektrike. Këto bateri do të jenë me tension nominal 2V, kapacitet nominal 500Ah (10h në 1.8Vpc). Lidhja do të bëhet me zbarë

sipas instruksioneve të prodhuesit. Urat lidhëse me impiantin e baterive do të jenë me kabullo të TU, fleksibël me seksion Cu 1x70 mm².

***FURNIZIMI ME UJE SHKARKIMET E UJRAVE TE ZEZA**

Aktiviteti nuk ka nevoja hidrike

***SIGURIA**

Per menaxhimin e qendres do te instalohet nje sistem i integruar akses-kontrolli dhe vezhgimi ne perputhje te plote me ligjshmerine perkatese. Per mbrojtjen kundet zjarrit parashikohet nje system i integruar i komponenteve aktiv dhe pasiv antizjarr ne perputhje me normat Evropiane te antizjarrit.

***Investimet per rruge**

Infrastruktura eshte ekzistuese, nuk do te happen rruge te reja.

e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

Objekti eshte i ngritur. Aplikimi per procedure te VNM behet, pasi ky aktivitet nuk i eshte nenshtuar me pare kesaj procedure. Pas kesaj, subjekti do te aplikojte per Leje Mjedisore Tipi B.

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;

Per kete aktivitet, nuk do te ngrihen objekte ndihmese.

f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)

Nuk do te kemi lende te para, pasi nuk do te ndertohen objekte ndihmese.

g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

Ky aktivitet ka lidhje te drejteperdrejte me shoqerine "Bloja" sh.a. dhe ka lindur si aktivitet bibe e saj. Lenda e pare merret nga "Bloja"

gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Ky aktivitet lindi si pasoje e zgjerimit te kompanise meme. Duke pare kerkesat ne rritje te tregut vendas per produktin e makaronit, u pa e arsyeshme qe te investohej ne kete linje prodhimi. Ambjenti ishte tashme i ngritur dhe u instalua vetem linja e prodhimit te makaronave.

i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Per zbatimin e ketij projekti nuk do te nevojitet ndertimi i kapanoneve apo rezidencave, pasi te punesuarit do te merren nga zonat perreth dhe nuk lind nevoja e te fjeturit prane objektit.

j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.

Subjekti eshte ne procesin e marrjes se VNM dhe Lejes Mjedisore.

k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Nuk disponon ende, pasi eshte ne fazen e marrjes se lejeve perkatese per zhvillimin e aktivitetit.